



Katalogu i produkteve

Lesh guri, rezistent ndaj zjarrit, izolim termik dhe akustik.



3

Grupi ROCKWOOL

4

Përse leshi i gurit ROCKWOOL?

5

Cilësi e verifikuar

6

Unike në treg

8

Sisteme akustike

10

Produkt me game të gjërë

12

Fasadat

15

Dyshemetë dhe tavanet

18

Çatitë

Përmbajtja



Për më shumë informacion

vizitoni faqen tonë web www.rockwool.com/al/
ode na dërgoni e-mail në marketing.adr@rockwool.com

Ndihmë dhe kontakt

Ne prodhojmë dhe ofrojmë një gamë të tërë produktesh të qëndrueshme dhe inteligjente izolimi për industrinë e ndërtimit, bazuar në teknologjinë inovative të prodhimit të leshit të gurit.

Nëse nuk jeni të sigurt se cilat produkte të zgjidhni, nëse keni pyetje teknike, nëse keni nevojë për ndihmën ose këshillën tonë në lidhje me projektin tuaj, mos ngurroni të na kontaktoni. Kolegët tanë të shitjeve dhe këshilltari teknik janë në dispozicionin tuaj.



Më shumë se 80 vjet...

Si pjesë e Grupit ROCKWOOL, ne duam të përmirësojmë jetën e të gjithë atyre që ndeshen me produktet tona. Ekspertiza jonë na mundëson të përballemi me sfidat më të mëdha të kohës në fushën e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit, pavarësisht nëse bëhet fjalë për konsumin e energjisë, ndotjen akustike, mbrojtjen nga zjarri, mungesën e ujit apo përmbytjet.

Me më shumë se 11,000 kolegë të përkushtuar në 39 vende, ne jemi lider botëror në zgjidhjet me bazë leshi guri, duke përfshirë izolimin

për ndërtesa, sistemet për izolimin e akustik të tavaneve, sistemet dhe veshjet e fasadave të jashtme, zgjidhjet e kopshtarisë, fibrat speciale për përdorim industrial, izolimin e përdorur në industrinë e procesit, aktivitetet detare dhe ato offshore.

Leshi i gurit është një material i gjithanshëm mbi të cilin bazohet i gjithë biznesi ynë për më shumë se 80 vjet, që kur filloi prodhimi i parë i leshit të gurit në Danimarkë, në një fabrikë pranë Kopehhagenit.



Gama e produkteve tona i përgjigjet nevojave të ndryshme në botë dhe në të njëjtë kohë inkurajon reduktimin e gjurmës së karbonit të të gjithë atyre që përdorin produktet tona ose bashkëpunojnë me ne.




Përse leshi i gurit ROCKWOOL?

Çlirojmë fuqinë natyrore të gurit

Guri është një nga burimet më të pasura natyrore. Jo vetëm që guri është një material natyral i rinovueshëm dhe i qëndrueshëm, ai gjithashtu bashkon një kombinim unik karakteristikash dhe avantazhesh

që përbëjnë bazën e biznesit të Grupit ROCKWOOL. Përgjatë shumë viteve ne zbuluam 7 fuqitë e gurit dhe i zbatuam ato për të krijuar një gamë produktesh që ndihmojnë në zgjidhjen e sfidave të sotme globale.



Cilësi e kontrolluar

Leshi i gurit dhe shëndeti



Leshi i Gurit ROCKWOOL ka shenjë Q të Direktives Evropiane (EC) Nr. 1272/2008 dhe sipas të cilës plotëson kriteret e biodegradueshmërisë dhe nuk është kancerogjen. Garancia e biodegradueshmërisë së leshit të gurit, apo fibrave të tij, është certifikata evropiane për sigurinë



EUCEB (Bordi Evropian i Çertifikimit për Produktet e Leshit Mineral) është një institut certifikimi që lëshon certifikata të konformitetit të produkteve me parametrat në markën Q të direktivës evropiane.

dhe cilësinë në EUCEB. Leshi i gurit ROCKWOOL përmbush të gjitha kërkesat e shenjës Q që do të thotë se kur thithen fibrat shpërbëhen shumë shpejt dhe nxirren nga trupi. Leshi i gurit

është prodhuar nga fibra të cilat nuk klasifikohen si të rrezikshme. EUCEB kontrollon vazhdimisht prodhimin dhe përputhshmëria lëshohet veçmas për secilen fabrikë.

Declaration of Performance No. CPR-DoP-ADR-035

1. Unique identification code of the product type: MIN-EN 13162-T5-D507L3-D507L50-CR16103-TR15-PLUS55-RE-WLPH-MW1

2. Identification of the product as required pursuant to Article 11(4) of the Regulation n° 305/2011: **ROCKWOOL ENERGY PLUS - FLATROCK 50 (see product label)**

3. Identification of the construction product, in accordance with the applicable harmonized technical specification, as foreseen by the manufacturer: Thermal insulation for buildings, (TMB)

4. Name, registered trade name or registered trade mark and contact address of the manufacturer as required under article 11(5) of the Regulation n° 305/2011: **ROCKWOOL AERIALTEC s.p.a.**, Proliferatëska zona Pritan Jug 136, Zgjedhje, VRR - 52333 Pöchlarn, Austria

5. Where applicable, name and contact address of the authorized representative, not applicable

6. Systems of a/CECP of the construction product as set out in Annex V of the Regulation (EU) n° 305/2011: System 1 and System 2

7. Member State: Certification body No. 2477 performed, carried out the initial type testing, the initial inspection of the manufacturing plant and of factory production control and the continuous surveillance, assessment and evaluation of factory production control and issued the certificate of consistency of performance. No. 2477-CPR-1888

8. Not applicable

9. Declared Performance

Essential Characteristics	Declared value (MPS)	Harmonized technical specification
Reaction to fire	4.2.2 Reaction to fire	A1
European classification	4.2.3 Reaction to fire	A1
Release of gaseous products in the fire situation	4.2.10 Release of gaseous substances	
Acoustic absorption index	4.2.11 Sound absorption	MPS
Impact noise transmission index (Dn, Fmax)	4.2.9 Dynamic stiffness	MPS
	4.2.10 Frequency A _w	MPS
	4.2.10.4 Compatibility	MPS
	4.2.10.6 Resilience	MPS
Over volume sound insulation index	4.2.10.6a Resilience	MPS
Collision sound insulation	4.2.10.6b Collision sound insulation	MPS
Thermal resistance	4.2.1 Thermal resistance and thermal conductivity	R _s 1,03 - 0,89 m ² K/W Thermal conductivity λ 0,035 W/mK
	4.2.2 Thermal conductivity	0,035
Water permeability	4.2.7.1 Short-term water absorption	W1
	4.2.7.2 Long-term water absorption	W2
Water vapour permeability	4.2.8 Water vapour permeability	μ 1,0
Compressive strength	4.2.3 Compressive stress or compressive strength	CR16/18
	4.2.3.1 Flexion	PLUS55
Duration of reaction to fire special track, including charring	4.2.7.3 Durability characteristics*	+
Quantity of thermal resistance against charring	4.2.7 Thermal resistance and thermal conductivity	+
4.2.7.1 Durability characteristics*	4.2.7 Durability characteristics*	DO/1,03 DO/0,89
Tensile/Peel strength	4.2.4 Tensile strength perpendicular to face**	MPS
Quantity of compressive strength against impact	4.2.6 Compressive stress	MPS

*No change in reaction to fire properties to be observed in practice. This is an essential characteristic of stone wool products. The declared performance of the product is based on the test results of the product. The manufacturer also carries testing and evaluation.

**The performance of the product identified in points 1 and 2 is in conformity with the declared performance in point 9. This declaration of performance is issued under the sole responsibility of the manufacturer identified in point 4.

Signed for and on behalf of the manufacturer by:

Signature: [Signature]

Version 1
Prepared: 14/06/2017
http://www.rockwool.com

ROCKWOOL
ROCKWOOL AERIALTEC s.p.a.
Proliferatëska zona Pritan Jug 136
Zgjedhje, VRR - 52333 Pöchlarn, Austria


Ligji për produktet e ndërtimit

(F.Zyrt. 76/13, 30/14, 130/17)

parashikon Deklaratën e Performancës (angl. "Declaration of Performance", shkurt DoP) me të cilën prodhuesi përcakton që vetitë e produktit korrespondojnë me vetitë e deklaruara. Bazuar në këtë deklaratë, prodhuesi është i detyruar të lëshojë markën CE për produktet e tij, në mënyrë që produkti të mund të tregtohet në tregun e BE-së. Deklaratat e performancës për produktet ROCKWOOL mund ti kërkonti dhe ti gjeni në formatin PDF në faqen tonë të internetit. Këto deklarata bazohen në numrin unik DoP që do ta gjeni të shënuar në paketim, domethënë në etiketën e produktit.



Unike në treg



Panelet me 2 shtresa prej leshi guri.

ROCKWOOL ofron panele prej leshi guri me dendësi të

dyfishtë, të prodhuara me teknologji unike; shtresa e jashtme me dendësi më të lartë siguron karakteristika mekanike më të mira ndërsa shtresa e brendshme me dendësi më të vogël përmirëson vetitë termiko izoluese. Për këtë arsye panelet izoluese me dy shtresa ROCKWOOL plotësojnë të gjitha kriteret kryesore edhe me trashësi më të vogël se panelet standarte:

- mbrojtje nga zjarri
- aplikim ekonomik
- izolim termik dhe akustik të shkëlqyer
- rezistencë më e madhe mekanike dhe rrjedhimisht jetëgjatësi e fasadës ose çatisë.

Shtresa e brendshme elastike përshtatet me nënshtresën dhe për shkak të forcës dhe kapacitetit të saj mbajtës, panelet mund të përdoren

edhe në sistemet me shtresa të trasha. Shtresa e jashtme me densitet më të lartë është e shënuar posaçërisht dhe duhet të jetë e kthyer gjithmonë nga jashtë.



Paketim me kompresim SLIMPACK

Slim pack - një sistem inovativ paketimi që ngjesh panelet e leshit të gurit, merr më pak hapësirë dhe ndihmon në reduktimin e emetimeve të dëmshme në mjedis. Teknologjia e re e kompresimit dhe paketimit rrit pamjen katrore të paneleve në paketë, kështu që ekziston një mundësi më e madhe e përdorimit të hapësirës gjatë ngarkimit, gjë që kontribuon në mbrojtjen e mjedisit dhe optimizimin e logjistikës. Analiza dhe krahasimi i sistemit të paketimit tradicional dhe atij të ri të kryer në Itali (AzeroCO2) vërtetoi se sistemi i paketimit Slim redukton numrin e dërgesave dhe ka një efekt pozitiv në ekonominë dhe mbrojtjen e mjedisit.



Paketimi tradicional
2 paleta nga 8 paketa















































Paketimi SLIM PACK
1paletë, 32paketa

Tabela tregon efektet pozitive të sistemit të ri të kompresimit Slimpack:

Paketimi	Numri i dërgesave me kamion Euro 5	sasia e produktit për kamion	KgCO _{2eq}	Rezultati
Tradicional	2 Dërgesa	3,04 ton	1900,80 m ²	340
Slim pack	1 Dërgesë	6,08 ton	3801,60 m ²	212
				Reduktim rreth 37% kgCO _{2eq}

Aplikimi i leshit të gurit

Tabela e të gjitha produkteve me aplikime

 Produkt me dy shtresa dendësie	Produkti	Përçueshmëria termike e deklaruar λ_D (W/[mK])	Rezistenca e fluksit të ajrit (kPa·s/m ²)	Rezistenca ndaj shtypjes σ_{10} (kPa)	Ngarkesa e pikës F_p (N)	Trashësia e disponueshme (mm)*	Faqja e katalogut
 Reagimi ndaj zjarrit							
							
SISTEMET AKUSTIKE – Muret ndarës							
	  Acoustic	0,035	≥ 12			30 - 250	11, 13
	  Acoustic EXTRA	0,033	≥ 25			30 - 250	11, 13
PRODUKTE ME NJË GAMË TË GJËRË- Muret ndarës, tavanet e varura, papafingot							
	  Multirock	0,037	≥ 6			40 - 200	13
	  Airrock ND	0,035	≥ 12			30 - 250	13
FASADAT							
	FASADAT E KONTAKTIT						
	  Frontrock Max Plus	0,035		≥ 15	≥ 200	50 - 300	15
	  Frontrock RPPT(FRONTROCK S*)	0,039		≥ 40		30* - 50	15
	FASADAT E VENTILUARA						
	  Ventirock Duo	0,035	≥ 20			60 - 200	16
	  Fixrock 33 VF	0,033	≥ 25			40 - 180	16
	  Fixrock 35 VF	0,035	≥ 12			40 - 180	16
DYSHEMETË DHE TAVANET							
	  Steprock Plus	0,037		≥ 20		30 - 70	18
	  Ceilingrock Plus	0,033		≥ 25		40 - 180	19
ÇATITË							
	  Hardrock 1000	0,039		≥ 70	≥ 1000	50 - 160	21
	  Hardrock Energy Plus	0,035		≥ 30	≥ 450	50 - 200	21
	  Hardrock 700	0,038		≥ 50	≥ 700	50 - 160	21
	  Hardrock 500	0,036		≥ 30	≥ 700	40 - 160	21
	  Dachrock 70	0,040		≥ 70	≥ 600	40 - 160	22
	  Dachrock 50	0,038		≥ 50	≥ 500	40 - 200	22
	  Dachrock 30	0,037		≥ 30	≥ 300	40 - 200	22

Sistemet akustike

Muret ndarës






Sistemet
akustike

Acoustic Acoustic EXTRA


Muret ndarës

ROCKWOOL Acoustic dhe Acoustic EXTRA janë panele izoluese akustike të prodhuara prej leshi guri për izolimin e akustik, termik dhe mbrojtje nga zjarri. Për shkak të strukturës së tij të fijëzuar, leshi i gurit zbut valët e zërit, prandaj përdoret për kërkesat e shtuara për izolimin akustik. Një veçori thelbësore që dallon panelet izoluese Acoustic dhe Acoustic EXTRA është rezistenca ndaj fluksit të ajrit, e cila përcakton aftësinë e materialit fibroz dhe poroz për të shpërndarë energjinë akustike përmes fërkimit. Rezistenca rritet me densitetin e materialit, dhe varet gjithashtu nga trashësia e fijeve dhe struktura e leshit të gurit. Vlerat e ulëta të rezistencës ndaj fluksit të ajrit tregojnë se materiali nuk është pengesë për kalimin e valëve akustike, ndërsa vlerat e larta tregojnë se materiali është "i papërshkueshëm" nga rrjedha e ajrit.



Aplikimi

Acoustic dhe Acoustic EXTRA janë panele të përshtatura për izolimin e mureve ndarëse, tavaneve të varura dhe sistemeve akustike. Kanë qëndrueshmëri afatgjatë që sigurojnë pandryshueshmëri të dimensioneve, densitetit si dhe orientimit dhe diametrit të fijeve.



Më shumë se



30%

e Popullsisë së Bashkimit Evropian është e ekspozuar ndaj niveleve të zhurmave që pengojnë gjumin e tyre

Vetitë	Standarti	Acoustic	Acoustic EXTRA
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_D)	EN 12667	0,035 W/mK	0,033 W/mK
Rezistenca ndaj fluksit të ajrit (AFr)	EN 29053	≥ 12 kPas/m ²	≥ 25 kPas/m ²
Koefiçenti i absorbimit akustik (d)	EN ISO 345	≥ 60 mm	≥ 60 mm
Dimensionet (mm)		1200 x 600	1200 x 600
Trashësia (mm)		30 - 250	50 - 160

Produktet me një game të gjërë

Muret ndarës
Tavanet e varura
Papafingot



MEET ME
AROUND
THE CORNER



Produkte
me një game
të gjërë


Multirock Airrock ND Acoustic, Acoustic EXTRA

Muret ndarës, tavanet e varura, papafingot

ROCKWOOL panele izoluese Multirock, Airrock dhe Acoustics prej leshi guri të përshtatura për izolimin e hapësirave të brendshme. Është e rëndësishme që strukturat që ndajnë hapësirën brenda vetë ndërtesës, si muret ndarëse, të kenë një fuqi mjaftueshëm të lartë izoluese të zërit për të parandaluar transmetimin e zhurmës ndërmjet dhomave, gjë që përmirëson ndjeshëm cilësinë dhe komoditetin e qëndrimit në hapësirë. Për shkak të strukturës së tij të fijëzuar, leshi i gurit ka një fuqi të madhe izoluese akustike dhe zbut në mënyrë të shkëlqyer valët e zërit.


Aplikimi

Panelet Multirock, Airrock dhe Acoustic përdoren si izolues termik, akustik dhe ndaj zjarrit në muret ndarëse parafabrikate të lehta prej gipsi, në izolimin e papafingove, tavaneve të varura dhe izolimin e mureve nga brenda. Ato mund të përdoren gjithashtu në sistemet e fasadave të ventiluara me përdorimin e një membrane të përshkueshme nga avulli si mbrojtje.



Vetitë	Standarti	Multirock	Airrock ND
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_D)	EN 12667	0,037 W/mK	0,035 W/mK
Koeficienti i absorbimit akustik (d)	EN ISO 345	≥ 60 mm	≥ 60 mm
Dimensionet (mm)		1200 x 600	1200 x 600
Trashësia (mm)		40 - 200	30 - 250

Fasadat






Fasadat e kontaktit (ETICS)

Gama e produkteve Frontrock

Sistemet e fasadave të kontaktit (ETICS) me një shtresë izoluese prej leshi guri janë zgjidhja optimale për mbrojtjen termike të veshjes së jashtme të ndërtesës, si dhe janë më të përshtatshmet nga pikëpamja konstruktive - fizike. Avantazhi i sistemeve të fasadave të kontaktit me lesh guri është e vazhdueshme, pra e pandërprerë, mbrojtje termike, akustike dhe kundër zjarrit e murit të jashtëm, pa ura termike.




Dendësia e dyfishtë e shtresave

Pllakat izoluese ROCKWOOL prodhohen duke përdorur një teknologji unike të patentuar. Në këtë mënyrë, karakteristikat e shkëlqyera termoizoluese të shtresës së brendshme elastike kombinohen me forcën e jashtëzakonshme dhe rezistencën mekanike të shtresës së jashtme, e cila ndikon edhe në karakteristikat e të gjithë sistemit të kontaktit. Shtresa e jashtme me densitet më të lartë është e shënuar posaçërisht me simbolin ROCKWOOL ose me vijë dhe duhet gjithmonë të jetë e kthyer nga jashtë.

Aplikimi

Panelet izoluese vendosen në bazë, pra në mur, duke u ngjitur me llaç polimerçimentoje dhe përforcohen me fiksues mekanikë. Më pas në panele aplikohet llaç për shtresën përforcuese dhe suva dekorative përfundimtare. Për të shmangur urat termike, elementët e panelit Frontrock përdoren për instalim rreth dritareve, dyerve dhe hapjeve të tjera të sistemit. Panelet izoluese ROCKWOOL rekomandohen për instalim të Sistemeve të fasadave të kontaktit me shtresa të holla dhe me shtresa të trasha dhe për izolim mbi hapësirën e jashtme si dhe mbi garazhe pa ngrohje. Panelet izoluese ROCKWOOL me karakteristikat e tyre sigurojnë mbrojtje nga zjarri, mbrojtje akustike, përshkueshmëri nga avulli, qëndrueshmëri dimensionale dhe jetëgjatësi të sistemeve të kontaktit.




ROCKWOOL Panelet izoluese Frontrock për fasadat e kontaktit janë një zgjidhje për çdo lloj ndërtimi, nga shtëpitë familjare deri tek ndërtesat e larta, dhe përdoren në ndërtime të reja dhe rinovime.

Vetitë	Standarti	FrontrockMaxPlus	FrontrockRP-PT
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_D)	EN 12667	0,035 W/mK	0,039 W/mK
Koeficienti i absorbimit akustik (d)	EN ISO 345	≥ 60 mm	≥ 60 mm
Dimensionet (mm)		1200 x 600	1000 x 600
Trashësia (mm)		50 - 240	30 - 50



Fasadat e ventiluara

Ventirock Duo Fixrock VF



ROCKWOOL Ventirock Duo dhe Fixrock VF janë panele izoluese të papërshkueshme nga uji për izolim termik, akustik dhe rezistent ndaj zjarrit në sistemin e fasadave të ventiluara. Ato janë projektuar posaçërisht për të qenë rezistente ndaj streseve të shkaktuara nga fluksi i ajrit në shtresën e ventiluar.

Ventirock Duo

Panelet izoluese me densitet të dyfishtë ROCKWOOL Ventirock Duo ofrojnë disa përparësi. Për shkak të forcës së lartë të shtresës së jashtme dhe rezistencës ndaj ujit të leshit të gurit, nuk ka nevojë të instaloni një film të përshkueshëm nga avulli dhe rezistent ndaj ujit mbi shtresën izoluese.


Shtresa e brendshme me densitet më të ulët përshtatet lehtësisht me parregullsitë e mundshme në mure, ndërsa shtresa e jashtme me densitet më të lartë mundëson fiksime mekanik të cilësisë së lartë me lidhëse dhe është rezistente ndaj

gërryerjes për shkak të fluksit të ajrit. Panelet izoluese Ventirock Duo sigurojnë kështu instalim të lehtë dhe ekonomik.

Fixrock VF

ROCKWOOL Fixrock Vf janë panele standarde izoluese prej leshi guri me densitet të barabartë në të gjithë seksionin. Panelet janë të laminuara nga njëra anë me një vello xhami në ngjyrë të zezë (FB1). Roli i vellos është të mbrojë sipërfaqen e paneleve nga gërryerja e mundshme për shkak të fluksit të ajrit. Përveç kësaj, velloja e xhamit shërben për të përmirësuar pamjen estetike të fasadave të ajrosura me fuga të hapura.

Panelet ROCKWOOL Ventirock Duo dhe Fixrock Vf fiksohen mekanikisht në bazë me një minimum prej dy fiksuesve për panel.



Vetitë	Standarti	Ventirock Duo	Fixrock 33 VF	Fixrock 35 VF
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	A1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_D)	EN 12667	0,035 W/mK	0,0339 W/mK	0,035 W/mK
Koeficienti i absorbimit akustik (d)	EN ISO 345	≥ 60 mm	≥ 60 mm	≥ 60 mm
Dimensionet (mm)		1200 x 600	1200 x 600	1200 x 600
Trashësia (mm)		80 - 200	40 - 180	40 - 180

Dyshemetë Tavanet





Produktet për izolimin e dyshemeve



ROCKWOOL Steprock janë panele izoluese prej leshi guri për izolimin akustik, termik dhe ndaj zjarrit të dyshemeve përdhe dhe dyshemeve lundruese të konstruksioneve të kateve të ndërmjetme. Për shkak të strukturës së fijëzuar dhe elasticitetit, pllakat izoluese ROCKWOOL kanë veti të shkëlqyera izoluese ndaj ajrit, dhe ajo që është edhe më e rëndësishme për dyshemetë, tingujt e goditjes. Zgjidhja më e mirë për zvogëlimin e zhurmës së goditjes në strukturat e ndërmjetme është vendosja e një komponenti elastik, për shembull një pllakë leshi guri, midis dy sipërfaqeve të ngurta, të tilla si çimento ose të ngjashme në kushte lagështire dhe një strukturë mbajtëse. Për produkte të tilla, është e rëndësishme që ato të jenë mjaft elastike për të zbutur dridhjet nga tingulli goditës, dhe gjithashtu mjaftueshëm të fortë për të mbajtur ngarkesën e parashikuar. Për të parandaluar formimin e urave termike dhe akustike, është e nevojshme që gjatë vendosjes së paneleve t'i kushtoni vëmendje sa vijon:


- në të gjitha buzët anësore rrethuese, është e nevojshme të vendosni breza leshi guri përpara se të instaloni vetë panelet. Funkcioni

i brezave prej leshi guri është të parandalojnë transmetimin e dridhjeve nga çimento ose të ngjashme të instaluar në kushte lagështire (estrihe) në strukturat vertikale ose muret, dhe përmes tyre në strukturat e tjera të ndërtesës. Brezi i leshit prej guri aplikohet minimalisht deri në lartësinë e shtresës së strihit të përfunduar.

- Para se të vendosni estrihet e lagura, është e nevojshme të vendosni një film PVC mbi panele për të parandaluar depërtimin e glazurës midis paneleve izoluese, që do të shkaktonte kështu shfaqjen e urave akustike dhe termike.

Aplikimi Steprock

Panelet ROCKWOOL Steprock rekomandohen për izolim termik, akustik dhe ndaj zjarrit të dyshemeve lundruese në hapësirat e banimit dhe ato komerciale. Ato vendosen nën striha të përforcuara të çimentos ose strihe të ngjashme të lagura. Panelet ROCKWOOL Ventirock Duo dhe Fixrock Vf fiksohen mekanikisht në bazë me një minimum prej dy fiksuesve për panel.



Vetitë	Standarti	Steprock Plus
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_p)	EN 12667	0,03 W/mK
Koeficienti i absorbimit akustik (d)	EN ISO 345	≥ 60 mm
Dimensionet (mm)		1200 x 600
Trashësia (mm)		20 - 50



Tavanet e
ambjenteve të
pangrohura

Ceilingrock Plus

Panelet izoluese ROCKWOOL Ceilingrock Plus prej leshi guri, të veshura nga njëra anë me një vello xhami të bardhë, përdoren për tavane në hapësira që frohen dhe të pa ngrohura. Velloja e bardhë prej xhami parandalon erozionin e grimcave të vogla të leshit të gurit dhe shërben për të reflektuar dritën. Produkti aplikohet kur nuk ka kërkesë për estetikë.



Aplikimi



Panelet izoluese ROCKWOOL Ceilingrock Plus përdoren për izolimin kundër zjarrit, akustik dhe termik të tavanit të hapësirave të pa ngrohura si bodrumet ose garazhet. Këto panele janë dimensionalisht të qëndrueshme gjatë ndryshimeve të temperaturës, kështu që pas instalimit të duhur nuk ekziston rreziku i urave termike.


1. Shtrimi i paneleve rekomandohet të fillojë nga mesi dhe të vazhdojë drejt skajeve.
2. Montohen pa nënstrukturë shtesë direkt në tavan me fiksime mekanike, mbajtëse metalike me disk dhe gozhdë.
3. Është e rëndësishme që gjatë fiksimit të mos dëmtohet sipërfaqja e panelit domethënë velloja prej xhami.



Vetitë	Standarti	Ceilingrock Plus
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_p)	EN 12667	0,033 W/mK
Koeficienti i absorbimit akustik (d)	EN ISO 345	≥ 60 mm
Dimensionet (mm)		1200 x 600
Trashësia (mm)		40 - 180

Çatitë






Çatitë e sheshta

Hardrock 1000

Hardrock 700

Hardrock 500

Hardrock Energy Plus



Panelet me dy shtresa ROCKWOOL

të prodhuara prej leshi guri kanë një rezistencë më të mirë ndaj ngarkesës së pikës në krahasim me panelet standarde të leshit të gurit me të njëjtën densitet në të gjithë seksionin tërthor. Shtresa e sipërme me densitet më të lartë ka një rezistencë të lartë ndaj dëmtimeve mekanike dhe goditjeve. Dendësia me dy shtresa u jep paneleve karakteristika të shkëlqyera mekanike dhe në të njëjtën kohë cilësi të përmirësuara të izolimit termik. Panelet me dy shtresa kanë një avantazh ndaj paneleve të tjera të çatisë për përdorim në kombinim me membranat e çatisë PVC ose TPO për shkak të mbështetjes së mirë elastike për fiksimin mekanik. Dendësia më e lartë e shtresës së sipërme është veçanërisht e dukshme



dhe e shënuar me shenjën ROCKWOOL ose me vijë dhe duhet të jetë gjithmonë e kthyer lart.

Aplikimi

Produktet me densitet të dyfishtë ROCKWOOL përdoren si mbrojtje nga zjarri, izolim termik dhe akustik të çatisë së sheshtë të padepërtueshme në fletë çeliku trapezoidale ose pllaka betoni të armuar. Mund të vendosen në një ose më shumë shtresa. Avantazhi i këtyre produkteve janë vlerat e larta të forcës për ngarkesën e pikës (deri në 1000N), që nënkupton rezistencë të lartë ndaj streseve që ndodhin gjatë ndërtimit të një çati të sheshtë dhe më vonë gjatë përdorimit. Një densitet mesatar më i ulët i shtresës izoluese krijon një ngarkesë shtesë në strukturën mbështetëse të bërë nga fletë çeliku shumë të profilizuar. Në të njëjtën kohë, shtresa e sipërme e pllakës izoluese me densitet më të lartë mundëson një kapacitet mbajtës të lartë të ngarkesës mekanike të strukturës. Për shkak të strukturës me dy shtresa, rekomandohet instalimi i këtyre paneleve në një shtresë. Në këtë mënyrë është i mundur një instalim shumë më i shpejtë dhe më ekonomik sesa kur izolimi vendoset në dy shtresa.

Vetitë	Standarti	Hardrock 1000	Hardrock 700	Hardrock 500	Hardrock Energy Plus
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	A1	A1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_D)	EN 12667	0,039 W/mK	0,038 W/mK	0,036 W/mK	0,035 W/mK
Ngarkesa e pikës në deformim 5 mm (PL(5))	EN 12430	1000 N	700 N	500 N	450 N
Rezistenca në shtypje në deformim 10%. (CS(10))	EN 826	70 kPa	50 kPa	50 kPa	30 kPa
Dimensionet (mm)		2000 x 1200	2000 x 1200	2000 x 1200	2000 x 1200
Trashësia (mm)		50 - 140	50 - 160	60 - 200	80 - 200




Çatitë e sheshta

Dachrock 70


Dachrock 50

Dachrock 30



Panelet standarte

Panelet Dachrock 70 Plus rekomandohen për izolimin e çatave të sheshta ku kërkohet rezistencë ndaj presionit të lartë, për sa i përket ngarkesës së çatisë. Falë mundësisë së prodhimit në trashësi më të vogla, ato përdoren shpesh në çati ku montohet një panel dyshtresor i kombinuar me një shtresë më të ulët panelesh me densitet më të ulët, si dhe për rehabilitimin e çatisë ekzistuese si një shtresë e hollë shtesë termoizoluese. Përdoret gjithashtu edhe në çatitë ku në vend të fiksimit mekanik përdoren membrana bituminoze me vetëngjitje.



Aplikimi

Panelet Dachrock 70 përdoren si shtresë një mbulimi për izolimin termik, mbrojtjen akustike dhe mbrojtjen ndaj zjarrit të çatave të tipit tarracë me strukturë betoni ose me profile llamarinash në formë trapezoidi (çati metalike). Montohen me ngjitje (zift i nxehtë, bitum ose ngjitës poliuretani), duke përdorur bashkimin me kunjë, ose mund të mbulohen me zhavorr të imët për mbrojtje kundra erës.

Panelet Dachrock 70 mund të përdoren në ndërtesat me dysheme të ngritura, aty ku ka kërkesa të larta për izolim termik dhe akustik dhe rezistencë të madhe mekanike. Në çatitë e sheshta me tarraca të qarkullueshme trashësia minimale e montimit duhet të jetë 60 mm.



Vetitë	Standarti	Dachrock 70	Dachrock 50	Dachrock 30
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	A1	A1
Përçueshmëria termike e deklaruar (λ_D)	EN 12667	0,040 W/mK	0,037 W/mK	0,037 W/mK
Ngarkesa e pikës në deformim 5 mm (PL(5))	EN 12430	600 N	500 N	300 N
Rezistenca në shtypje në deformim 10%. (CS(10))	EN 826	70 kPa	50 kPa	30 kPa
Rezistenca ndaj tërheqjes pingul me faqet (TR)	EN 1607	15 kPa	10 kPa	10 kPa
Dimensionet (mm)		2000 x 1200	2000 x 1200	2000 x 1200
Trashësia (mm)		40 - 1640	40 - 200	50 - 200

Ne jemi të përkushtuar që t'jua lehtësojmë të gjithëve sfidat e jetës moderne. Duke përdorur gurin, një lëndë e parë natyrore e pashtershme, ne lëmë gjurmë të qëndrueshme ndër breza.

Leshi i gurit përmirëson punën dhe mirëqenien e njerëzve në mënyra të ndryshme. Zgjidhjet tona ndikojnë ndjeshëm në pasurimin e jetës së njerëzve, e cila bëhet edhe më produktive dhe e bukur.

Ndoshta, Ju, kurrë nuk do t'i mësoni këto sekrete të fshehura në botën moderne dhe nuk keni pse t'i dini. Jemi krenarë që e ndjeni performancën e tyre çdo ditë.

Shënim ligjor: Ky dokument ofron informacion të përgjithshëm për produktet ROCKWOOL që janë të disponueshme në tregjet e ROCKWOOL Adriatic d.o.o.. Informacioni i përgjithshëm nuk është garanci për parametrat teknikë të një produkti specifik. Këto parametra janë të disponueshëm në departamentet tona teknike dhe të shitjeve, të cilat, me kërkesë të klientit, ofrojnë të dhëna të përshtatshme dhe certifikata të lidhura për produkte individuale. Ankesat që i referohen këtij dokumenti dhe janë të shprehura në të janë të pabaza dhe ne i refuzojmë paraprakisht. Ne rezervojmë të drejtën për të ndryshuar përmbajtjen e dokumentit në çdo kohë pa njoftim paraprak.

ROCKWOOL ADRIATIC d.o.o.

Zyra e shitjes

Radnička cesta 80
HR - 10000 Zagreb
Tel+38516197600
Fax+38516052151

Selia dhe prodhimi

Poduzetnička zona Pićan Jug 130, Zajci
HR-52333 Potpićan
www.rockwool.com/al/

